



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Mbledhja nr. **72/2024**

Data: **30 dhjetor, 2024, ora: 13:30**

Vendi: **Selia e KQZ**

Kryesues i KQZ-së: Kreshnik Radoniqi.

Anëtarët e KQZ-së: Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Ilir Gashi, Sami Hamiti,
Alban Krasniqi, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Fazli Stollaj, Qemailj

Në takim ishin të Kurtis, Mufera Shinik

pranishëm:

U.D. Drejtori i SKQZ dhe Drejtor i ZRCKFSP: Besnik Buzhala

Përkthyes: Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi

Rendi i Ditës

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

2. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit të Komisionit për Kundërshtim Administrativ

3. Këshillat e KQZ

3.1. Këshilli për Operacione Zgjedhore

3.1.1. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për ndryshimin e lokacionit të QKN-së komuna Skenderaj

3.1.2. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për ndryshimin e lokacionit të QV-së 1710 komuna Pejë

3.1.3. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesave dhe specifikimeve për shtypjen e fletëvotimeve, broshurave dhe listave votuese për Zgjedhjet e rregullta për Kuvendin e Republikës së Kosovës 9 Shkurt 2025

3.1.4. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesave dhe specifikimeve për shërbimet postare lidhur me votimin jashtë vendit për Zgjedhjet e rregullta për Kuvendin e Republikës së Kosovës 9 Shkurt 2025

3. Të ndryshme

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Kryetari **Radoniqi**, pasqyroi agjendën para anëtareve, dhe pyeti nëse ka dikush ne te ndryshme. Arianit Elshani, tha se meqë dy pika nuk kane kaluar ne KOZ dhe ka mbetur te shqyrtohen serish. Behet fjale për pikat: “Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për ndryshimin e lokacionit të QKN-së komuna Skenderaj, dhe Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për ndryshimin e lokacionit të QV-së 1710 komuna Pejë”. Pra, këto dy pika te largohen nga rendi i ditës.

Me 11 vota për, u miratua rendi i ditës.

2. Aktivitetet e Sekretariatit

Kreshnik Spahiu, drejtor i IT-së, tha se Sekretariati ka vazhduar me pranimin e aplikacioneve deri me datën 27 dhe 28 dhjetor. Kane ardhur kundërshtimet e palëve te pakënaqura, dhe gjithsej janë 21 kërkesa që janë aprovuar, 151 kërkesa që duan të kthehen në “listën votuese qendrore” nga “lista votuese jashtë Kosovës”, ndërsa 179 kërkesa të cilat janë hudhë si të palejuara sepse nuk i kanë plotësuar kriteret teknike që të bëhet kundërshtimi administrativ, dhe janë refuzuar 154 me rekomandimin e komisionit.

Alban Krasniqi, tha se procesit të regjistrimit i ka parapri një rregullore në kohën kur platforma nuk ka qenë e përfunduar. Ne, nuk kemi pasur si ta dimë se si do të funksionalizohet platforma, dhe sa do të jetë funksionale rregullorja me platformën. Tërë procesi, tha Krasniqi, ka qenë i privuar nga informimi që, është obligim për publikun. Informimi, ishte i mangët dhe kjo ka krijuar mangësi. Ne, vetë platformën nuk

e kemi shpjeguar mjaftueshëm për publikun ! Sikur mos të ishte numeri i telefonit, që ishte i qasëshëm, vështirë se do ti informonim qytetarët me mënyrën se si duhej aplikuar. Ka pasur angazhim por, jo mjaftueshëm. Do të donim me ditë saktë se prej 154 aplikuesve të refuzuar, sa janë që e kanë dëshmuar se i plotësojnë kriteret, por që nuk kanë arritur ta plotësojnë ta zëmë, një kriter teknik. Në kuptimin teknik, sa raste janë sepse, ata kriteret ligjore duhet ti kenë plotësuar...?

Kreshnik Spahiu, tha se 154 rastet janë raste të refuzuara në fazën e aplikimit, ata që nuk e kanë dërguar dokumentin me fotografi (109 raste), por ka edhe raste që janë me dy apo tri mos plotësime të kriterëve, si mungesa e dokumentit të vlefshëm...

Alban Krasniqi: Propozimi im është që ne këto 109 raste mor ti aprovojmë për me ua pamundësuar regjistrimin. Por, meqë e kanë dëshmuar identitetin e tyre, unë mendoj se i kanë plotësuar kriteret ligjore për me qenë votues. Komisioni, për një arsye apo tjetër, janë refuzuar por ne mund ta autorizojmë Shërbimin Votues që të njëjtit ti aprovojmë...

Ilir Gashi: Pse është ardhur në këtë rekomandim ? Nga këtu, mendoj që mund të apelojmë që secili qytetarë ta ketë certifikatën e tij të regjistrimit, dhe ta ketë bërë vet aplikimin dhe jo dikush tjetër, apo te dikush tjetër. Bëj thirrje që, ata të cilët nuk janë regjistruar individualisht por nga dikush tjetër, kjo përbën shkelje ligjore – penale.

Diskutuan: **Sami Kurteshi**, i cili tha se dokumentacioni duhet të jetë i kompletuar, individualisht. Në një pako duhet të jetë një fletëvotim, dhe jo më shumë, se këto gabime nuk lejohen... **Arianit Elshani**, tha se ky proces do ndahet në faza, shorti, miratimi i fletëvotimit dhe njoftimi i atyre që do të votojnë përmes postës. Njoftimi i atyre që votojnë në përfaqësitë diplomatike. Këto informacionet dhe të tjerat, janë në përgatitje e sipër... Lidhur me rekomandimin për refuzim, unë votoj për ata që i kanë plotësuar kriteret, unë jam që të mos refuzohen. **Sami Kurteshi**: nëse janë plotësuar kriteret që po i thonë edhe kolegët, ne s’kemi pse t’i refuzojmë, i miratojmë dhe nuk kanë pse shkojnë në PZAP. Sami Hamiti, tha se faza e kundërshtimit ka kaluar, por edhe unë mendoj se nëse ata i kanë plotësuar kriteret ligjore, të hyjnë në listë dhe mos të shkojnë në PZAP. Por, rastet e diskutueshme, duhet të shihen...

Kreshnik Spahiu: Janë 26 persona që nuk mund të futem në listë.

Ibrahim Selmanaj: Te aplikantët sa ka mbërrë numër “107 mijë”, kërkoj që të bëhet verifikimi tek imellat që vijnë ma shumë se katër emra të ndryshëm. Ti shfrytëzojmë mundësitë që procesin ta kemi sa më të besueshëm, numrin e aplikantëve, dhe komisioni të vijë me një raport të detajuar dhe, ta shohim edhe ne atë raport me kujdes...

Kreshnik Radoniqi: Kush është për që 128 aplikues të përfshihen dhe, 26 të refuzohen ?

Me 11 vota ëpr, miratohet ky rekomandim.

3.Këshillat e KOZ

Këshilli për Operacione Zgjedhore

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesave dhe specifikimeve për shtypjen e fletëvotimeve, broshurave dhe listave votuese për Zgjedhjet e rregullta për Kuvendin e Republikës së Kosovës 9 Shkurt 2025:

Arianit Elshani: KOZ ka shqyrtuar specifikat për shtypjen e fletëvotimeve, broshurave dhe listave votuese për Zgjedhjet e rregullta për Kuvendin e Republikës së Kosovës 9 Shkurt 2025. Ky proces i tenderimit, herën e parë ka dështuar sepse 2 operatorë kanë ofertuar me vlerë më të lartë se paramasa e llogaritur nga ana e KOZ, dhe për shkak se 3 operatorë të tjerë që kanë ofertuar nën vlerën e paramasës, kanë qenë të papërgjegjshëm në ofertën e tyre. Ne si KOZ, rekomandojmë që të iniciohet një procedurë e **negocimit**, pra të kontraktohet përmes negocimit dhe që të ndryshohen specifikimet që të kërkohet vetëm kontraktimi i shtypjes së fletëvotimeve, broshurave dhe listave votuese vetëm për zgjedhjet parlamentare, dhe jo ato lokale. Kemi llogaritur më parë ky proces brenda një procedure tenderuese të dy palë zgjedhjet, mirëpo meqë tani do ti nënshtrohemi një procesi të negociuar në mënyrë që ti kemi fletëvotimet në kohë këtë në vendvotime por edhe në përfaqësitë diplomatike, atëherë të iniciohet një procedurë e negociuar në raport me sasinë.

Sasia, është e njëjte me atë që ka qenë e planifikuar më parë, vej në rastin e votimit me kusht ku është rritur numri për shkak të keqkuptimeve që kemi pasur në mbledhjet e KOZ-it ku nuk është përçuar mesazhi nga një mbledhje në tjetër, pra me këtë rast edhe te departamenti përkatës për përgatitjen e këtyre specifikave. Si KOZ, rekomandojmë që të miratohen këto specifika. Shuma e caktuar është 290, 000 euro para masa. Kriteret e siguris2ë nuk kanë ndryshuar...

Me 11 vota për miratohet ky rekomandim.

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesave dhe specifikimeve për shërbimet postare lidhur me votimin jashtë vendit për Zgjedhjet e rregullta për Kuvendin e Republikës së Kosovës 9 Shkurt 2025:

Arianit Elshani: Gjithashtu, janë shqyrtuar edhe specifikat për shërbimet postare lidhur me votimin jashtë vendit për Zgjedhjet e rregullta për Kuvendin e Republikës së Kosovës 9 Shkurt 2025. Janë specifikat që duhet të kontraktkohet një operator lidhur me shërbimin postarë të transportimit të materialit nga Kosova drejt përfaqësive diplomatike, drejt ambasadave. Aty ku do të hapen kutitë postare duhet të transportohen materialet josenstive: shiritat e sigurisë dhe thasët për grumbullimin e zarfeve, pastaj edhe dërgimin e tyre drejt Kosovës. Dhe po ashtu, për dërgimin e kutive të votimit bashkë me materialin tjetër zgjedhor: fletëvotimet që do të dërgohen nga Kosova në përfaqësitë diplomatike dhe pastaj, kthimi prapa i tyre në Kosovë.

Ky proces tenderues, tha z. Elshani, po ashtu ka dështuar në procedurë të hapur dhe sërish rekomandohet që vazhdohet me një proces të **negociuar** kontraktimit nga ana e administratës për shkak të kohës së kufizuar. Po ashtu, ishte llogaritur më parë ky proces brenda një procedure tenderuese të dy palë zgjedhjet, mirëpo tani duhet ndarë dhe të bëhet vetëm për zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit.

Me 11 vota për miratohet ky rekomandim.

Këshilli për Personel

Alban Krasniqi: Kemi pasur një konsultë sepse, nuk kemi mundur të takohemi në këshill. Kemi diskutuar fazën e 6 – të rekrutimit. Dhe në bazë të kërkesave që kanë ardhur nga njësitë kërkuese, por edhe mbi bazë të ekonomizimit sa më të mirë të stafit jo permanent, pra, një praktikë e re që ruan edhe resurse po edhe buxhet, kemi 35 kërkesa të ardhura: trajnimi, IT, logjistika, organizimi i QNR-së. Është lista e bashkangjitur. Kjo është faza e 6-të, dhe rekomandojmë aprovimin sepse, e kam diskutuar edhe personalisht me njësitë kërkuese.

Me 11 vota për miratohet ky rekomandim

Të ndryshme !

Alban Krasniqi: Po e vazhdoj te informimi , pra, informimi si për nga koha dhe kualiteti duhet të jetë aktiv, sepse jemi në procese tjera shumë të rëndësishme. Tu ofrojmë qytetareve sa më shumë mundësi për procedurat, të drejtat, procesin...

Periodha e votimit jashtë Kosovës, është më aktualja dhe kërkon nga divizioni i informimit, shërbimi votues që këto dy departamente të ofrojnë një pako informuese për votuesit me kohë. Informimi të jetë dinamikë, sepse mënyrat, metodat e informimit duhet të jenë specifike, të shpejta, të kemi një plan. Edhe për personat me nevoja të veçanta, të bëhet informimi që të jetë i qasshëm informimi.

Një çështje tjetër, e cila është përmendur por nuk kemi hapa konkret: lirimi i hapësirës së QNR-së për ti zhvilluar aktivitetet. Fatmirësisht në kuadër të MPB-së, është siguruar një hapësirë shtesë për materialet si kamerat që, ato sigurohen. Nuk ka aq lëvizje rreth QNR-së, dhe kërkoj nga Sekretariati që urgjentisht të lirohet hapësira...

Në këtë pikë, diskutuan: Arianit Elshani, Myfera Shinik, që kërkoi informim në gjuhët përkatëse...